



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KURBIN

KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4961/prot.
5

Laç, më 06 / 11 2025

VENDIM

Nr. 38, datë 03 / 11 .2025

“PËR MIRATIMIN E LISTËS SË FAMILJEVE QË PËRFITOJNË SUBVENSIONIMIN E INTERESAVE TË KREDISË PËR VITIN 2025”.

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, të ligjit nr.22/2018 “ Për strehimin Social” i ndryshuar, vkm nr 384 datë 12.06.2019 “ Për përcaktimin e procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, vkm nr.301 date 15.04.2020 “ Për normat e strehimit si dhe kushtet e standartet për banesat sociale me qira që blihen ne treg dhe banesat me kosto të ulët”, vkm nr 268 datë 29.04.2022 “ Për disa ndryshime dhe shtesa ne vkm 453 datë 03.07.2019, për masën e subvencionimit të interesave të kredisë dhe procedurat e dhënies së tij, për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuar nga shteti “, vkb nr.20 datë 23.02.2024 “ Për miratimin e sistemit të pikëzimit për programet sociale të strehimit”, shkresën nr 15406 prot datë 06.12.2024 “ Mbi programin e subvencionimit të kredisë” shkresën nr 68591 prot datë 21.05.2025 të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit “Mbi nivelin e të ardhurave maksimale për të përfituar nga programi i subvencionimit të kredisë “ si dhe Raportit nr 4961/1 “ Raport i plote për propozimin e e miratimit të listës së familjeve që përfitojnë subvencionimin e interesave të kredisë për vitin 2025” të hartuar nga Komisioni i Strehimit pas propozimit nga Kryetarja e Bashkisë, Këshilli Bashkiak:

VENDOSI;

1. Miratimin e listës së përfituesve dhe masën e subvencionimit të interesave të kredisë për individë/familje që përfitojnë banesa me kosto të ulët, me kredi të lehtësuar nga shteti, sipas listës bashkëlidhur.
2. Drejtoria e Shërbimeve Publike të njoftojë familjet/individet, që përfitojnë subvencionimin e interesave të kredisë për vitin 2025, si dhe ata/ato që nuk kanë përfituar nga ky program, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e miratimit të listës së përfitues

Ky vendim hyn në fuqi 10(dhjetë) ditë pas shpalljes .
Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

>Drejtoria e Sherbimeve Publike .


>Drejtoria e Financave

>Arkivit

Sekretari i Këshillit
Arber Leka



Kryetare e Këshillit
Edlira Lleshi



Lista e përfituesve për programin "Subvencionimi i interesave të kredisë, të lehtësuara nga shteti"

Nr.	EMRI/A TËSIA/MBIEMRI	Përberja familjare	Struktura e apartamentit që përfiton	Kushtet e strehimit nën 16germa (a)	Kushtet familjare nën 16germa (b)	Kushtet sociale nën 16germa ©	Të ardhurat majore neto të familjes në leke	Punësimi	Kufiri maksimal i kredisë që përfiton familjari
1	Leo Muharrem Xhepa	4	2+1	Nuk disponon banesë	Familje e re		73,305	Shtet	3.021,300
2	Rafael Ramazan Hasani	4	2+1	Nuk disponon banesë	Familje e re	Minoriteti egjiptian	75,964	Privat	3.021,300
3	Kleson Pellumb Gjona	4	2+1	Nuk disponon banesë	Familje e re	Person me PAK	71,040	Privat	3.021,300
4	Prende Pashuk Leshaj	6	3+1	Nuk disponon banesë			66,276	Shtet	3.730,000
5	Gentian Geg Rica	3	2+1	Nuk disponon banesë	Familje e re		63,000	Shtet	3.021,300
6	Aleksander Esete Caci	3	2+1	Nuk disponon banesë	Familje e re		84,400	Privat	3.021,300
7	Vjollca Ndreç Lleshaj	4	2+1	Nuk disponon banesë		Person me PAK	37,000	Privat	3.021,300
8	Klodjan Fran Tusha	3	2+1	Nuk disponon banesë	Familje e re		99,140	Privat	3.021,300

Sekretari i Këshillit
Arber LEKA



Kryetare e Këshillit
Edlira LIQESHI